Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno, dt. Dana | 18-12-2024 | | |
|---|---|---|---|
| Nr. Fortpanal Org. Broj | | Shtojce Prilog | Vlera Vrednost |
| 01- | 060 | 01- | 1460 |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-XII-** të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **26.12.2024 (e Ejte)**, duke filluar në ora **10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të shtëpisë së kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

## R e n d  d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbdhjet e Kuvendit Komunal.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës se veçantë të prona të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2025.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komisionit për shqyrtin e ankesave për dhënien e pronës se komunës ne shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë**
4. **Propozim vendim për aprovimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2025**
5. **Raport për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Vitisë për vitin 2024.**
6. **Propozim per shqyrtimin dhe miratimin e propozim planit për punën e këshillit komunal për siguri bashkësi për vitin 2025.**

**Viti, më 18.12.2024**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## I MBLEDHJES SË NJËMBËDHJETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 27.11.2024 (e mërkur) në Shtëpinë e Kulturës "Gursel dhe Bajram Sylejmani", duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ali Bajrami, z.Ramadan Deliu, z.Basri Sylejmani, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ilir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Sokol Hyseni, znj.Marigona Avdiu. z.Arbnora Hajredini, z.Jakup Demiri, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi. znj.Majlinda Shabani, z.Taulant Haxhiu, znj.Zyrafete Rama, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Anisë Zejnullahu, ndërsa mungoi z.Sokol Shaqiri, znj.Liridona Bislimi, z.Musli Neziri, z.Veton Ramadani, z.Reshat Azizi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike dhe të tjerë. Pasi u konstatua se prezent janë 22 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, mirë se keni ardh në mbledhjen e njëmbëdhjetë për këtë vit të kuvendit. Gjatë kësaj periudhe shumica e akteve janë kthy në përputhje me ligjin. E dimë që jemi në prag të festave të nëntorit, neser ështe dita e 28 Nëntorit - Pavarësisë së Shqipërisë, Dita e Flamurit, dhe ju e dini që neser kemi seancë solemne, në ora 9:30 të jeni prezent. Uroj për festat e nëntorit të gjith qytetarët e Komunës së Vitisë dhe gjithë shqiptarët ku do që janë. Para se me kalu në rend të ditës hapi debatin për pyetjet dhe përgjigje duke ju kërku që të ju përmbahemi kohës.

**z.Ali Bajrami:** Përshendetje të nderuar të pranishëm! Nuk do të parashtroj pyetje. Qëllimi im është që kjo seancë të kaloj në mënyrë solemne për shkak të festës së Ditës së Flamurit dhe Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ju të pranishëm dhe qytetarë të Komunës së Vitisë, në emrin tim dhe në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së ju uroj Festën e Flamurit, Ditën e Pavarësisë së Shtetit Shqiptar.

**z.Ilir Zuka:** Kam pyetje për drejtorin e urbanizmit për vendosjen e numrave që është tu bë, me naj dhanë një shpjegim drejtor, se në shumë shtëpi në Pozharan janë vendos nga dy tre numra. Besoj që drejtori e din arsyen dhe ne ta njofton qytetarin. Kam edhe një falenderim per drejtorin e shërbimeve publike. Kjo rruga Pozheran - Viti dijet që u kanë një rrugë shumë e rrezikshme edhe ndoshta çdo javë po ka aksidente, po në konsultim me drejtorin e kan marr një iniciativë, d.m.th që janë kanë ato therrat që janë kanë përreth rrugës, e din që dy ditë janë tu hek. Faleminderit drejtor për punën që je tu e bë!

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Së pari më lejoni që në emrin tim dhe të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje të ju uroj Festën e Pavarësisë së Shqipërisë, apo Ditën e Flamurit të gjith qytetarëve të komunës sonë. I kam dy pyetje. Njërën për sheshin: a e dini se kur përfundon? Se tash ma vetëm që po him në muajin dhjetor. Dhe pyetja e dytë ka të bëjë me gjendjen e objektit të Muzeut të Qytetit. Masi që është afër komunës, nuk di se sa e keni pa, po është një gjendje aspak e mirë kur lagështija vetëm sa e ka kaplu kogjo shumë përbrenda. Nuk e di, prej dritareve nga jashtë sa e kemi pa aty, është rrëmuj dhe kur u pas rregullu e ka pas përuru, e ka qenë një objek që mendojshmi që ka me qenë përnime muze i qytetit, po tash është bë jo pasqyrë e mirë për qytetin tonë.

**z.Lindita Demelezi:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Urime festa edhe nga ne! Kam një pyetje për sigurinë në rrugë. Duke marr parasysh rrezikun e aksidenteve në rrugë që kanë kthesa të ashpra dhe ndodhen përgjat lumit. A mund të shqyrtohet vendosja e barrierave mbrojtëse, barriera metalike ose të betoni për të rritur sigurinë e qarkullimit dhe për të mbrojtur automjetet nga rënia në lum? Po ashtu edhe për të shenjëzuar aty. Pyetja tjetër, vendosja e numrave nëpër shtëpi. Në disa shtëpi janë vendos gabim e në disa hiç. Kur pritet të përmirësohen këto?

**znj.Mjalinda Shabani:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë i kam dy çështje. E patëm bë një kërkesë në mbledhjen e KPF-së që me na ardh lista e punimeve që janë bë në Komunën e Vitisë dhe që nuk kanë pranim teknik. Pyetja ime e parë është se, kur ka me ardh kjo listë? Sepse na duhet neve me e pa. Dhe pyetja tjetër është një adresim që vie prej banorëve të shfatit Lubishtë, të cilët tani janë me vendbanim në fshatin Ramnisht, ku prej vitit 2020 kanë bë një kërkesë për mu shtru një rrugë asfaltim, ku është dikun 130 metra. Po besoj që kërkesën e keni marr, atëhere me kohë edhe kish dashtë me pyet nënkryetarin, pse nuk është realizu kjo kërkesë, edhe a ka mundësi me u bë në këtë afat.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Te lista e pranimit teknik, ka pas Zyra e Prokurimit nuk naj ka pru si informatë. Ne e kemi kërku atë ditë që me e pru, mirëpo Zyra e Prokurimit nuk e ka pru si informatë.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kemi qenë edhe ne të interesum që të japim sa më shumë informata rreth këtij procesi për qytetarët. Kemi shfrytëzu edhe faqen e komunës. Procesi i vendosjes së numrave është gati në përfundim, jan vendosur mbi 8 mijë numra në Komunën e Vitisë, 3 mijë do të vendosen në javën e ardhshme. Problemi pse jan vendos 2 numra diku e asnjë diku është se, kur janë vendos numrat në sistem është përdor harta më e re, fotografimi më i ri është i 2018, prandaj objektet e vjetra që kanë qenë nëpër shtëpi, vendosja e numrit në sistem ka ndodh para 7 viteve, kështu që prej atëhere kemi ndryshim të gjendjes në teren. Pasi ta përfundojmë procesin në javën tjetër, ne do të mirremi me sanimin e këtyre problemeve. Në ato që nuk ka numra do ti vendosim aty. Ku janë ka 2 do t'i marrim dhe do t'i lajm si numra rezervë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasi që jemi në prag të festës se 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit, më lejoni që të ju uroj të gjithëve qytetarëve të Komunës së Vitisë, me shpresë që nëntorët e ardhshëm edhe me punë me të mira. Para se me hy tek pyetjet, do të kish dhënë një arsyetim për mungesën e drejtorave që mundet me pas naj pyetje. Drejtori i bujqësisë mungon me arsye, që ka pikë të rendit të ditës. Drejtoresha e arsimit dhe e financave mungojnë me arsye. Unë do të jem në përgjigjet e tyre. Edhe e kemi një ndryshim tek pika e shtatë e rendit të ditës, tek anëtarja Vjollca Gashi, vjen Mirlinda Sylejmani – Zuka. Pyetje për sheshin i cili duhet të përfundoj deri me datën 15 dhjetor, jashtë kësaj date ekziston rreziku me i humb mjetet, se mjetet janë nga DEMOS-i dhe kontrata ka qenë dyvjeçare. Dje e kemi pas takimin e fundit që jam marr edhe unë bukur shumë, prandaj u shtu intensiteti. Sa do të ja arrim të shofim. Gjendja e museut edhe per neve është shqetësuese po kete vit nuk kemi nda nuk kemi pas mjete unë kam bisedu me kompanin ju e dini që ka qenë një donacion i huj jan bë disa intervenime që ju e dini që nuk kan rezulutu kompanis i ka skadu garancioni nuk ka pas mirëkuptimin timë të cilin un e kam lut përshkak se në plotni pajtoj që muzeu duhet të pasqyroj nga vetënocioni dhe emërtimi që ka dhe dedikimi për qka është, do ta kemi parasysh që vitin e ardhshëm të eliminohet kjo qështje dhe ta merrë funksionalitetin e vetë të plotë. Vendosja e barrierave në vendet të cilët janë me kthesa, Komuna e Vitisë pak karakterizohet me territor të tillë. Në rast se ka mundësi me i parapa drejtori i shërbimeve publike, ato janë të kushtueshme, por megjithatë çështja e vendosjes së këtyre shenjave të komunikacionit dhe çështja e shprehjes së profesionalizmit, besoj se tash e tutje do të kemi mundësi me shtru kërkesë se tani jemi kompletu me stafë, kemi dhe inspektor të komunikacionit. Kërkesa për projketet që nuk kanë pranim teknik. Kjo kërkesë ka qenë në kuvendin e fundit që unë nuk kam qenë pjesëmarrës, por do ju drejtohem Zyrës së Prokurimit, që në seancën e dhjetorit ju me i pas të gjitha ato që kemi kërku. Kërkesa për shtrurjen e një rruge në Ramnishtë në gjatësinë 130 - 150 metra, saktësisht nuk mund të themë, është e parapamë e di që para 2 ditë kam nënshkru një kontratë me punë kryersin ishin 69 rrugë të përfshime. A është kjo rrugë apo jo nuk kam njouri në detaje. Kjo është shty se ka pas një ankesë në OSHP. Në seancën tjetër muj me ta siguru a është kjo rruga e Ramnishtes apo jo.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Materialin e keni marrë me kohë. për këtë seancë kemi parapa këtë:

**R e n d d i t e**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm ngastrën kadastrale në zonën kadastrale në Vërban.**
7. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratim të dy anëtarëve të komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve për institucionet edukativo arsimore të nivelit, parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunën e Vitisë.**
8. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba me Nr. 01-110/05-1151, e datë 30.09.2024.**
9. **Informatë nga Drejtoria për Bujqësi për planin operativ për mbjelljet vjeshtore për vitin 2024-2025.**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi diksutim për rendin e ditës. Pasi që nu pa për disktuim: a jeni për miratimin e rendit të ditës? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë votë abstnim miratohet randi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Atëhere, me të gjitha votata pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin për pronat e paluajtshme për vitin 2025**

**z.Xhelal Veseli, udhëheqës i tatimit në pronë:** Kjo është vazhdimsi e vitit 2024 dhe nuk ka ndonjë ndryshim. Materialin e keni marrë me kohë, nëse keni ndonjë pyetje jam në dispozicionin tuaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat e qes në votim. Atëhere, me të gjitha votata pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet dhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedures së shprehjes së interesit**

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Me këtë propozohet të jepet pëlqim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatgjatë për persona fizik dhe juridik deri në 20 vite për veprimtari biznesore, respektivisht për panela solare në dy vende, në Devajë. Kjo shkon me ankand, me oferta, mandej kthehet në kuvend. Me këtë vetëm jemi tu e dhanë pëlqimin për me inicu procedurën. Materialin e keni marrë me kohë, për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**z.Jakup Demiril:** Ne si grup parlamentar i LVV-së e kemi një propozim që nga 20 vite të zbritet në 15 vite. Ky është qëndrimi jonë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A lejohet që të parashihet panele solare në këto pjesë, a e lejon plani zhvillimor, dhe a ka pas nevojë të ketë diskutime publike me banorë që mos të kemi më vonë telashe?

**z.Ali Bajrami:** Drejtoresha obligimin ligjor që ato që parashihen me u dhanë për vitin 2025 është obligim ligjor me u kry në vitin 2024. Pyetja shkon për drejtorin e urbanizmit: me PZHK dhe me hartat zonale a është e parapamë ajo pjesë që të parashihet për me u dhanë përmes ankandit për vendosjen e panelave solare dhe a

lejohet afërsia në ato lokalitete? Biseda, kontakti me qytetarë. Krejt këto mos të binë ndesh me marrë vendim me dhanë dhe me na u kthy si e kundërligjshme.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Parcela në fjalë tash me PZHK është e parapamë, mirëpo ka mundësi me harta zonale që nëse ka zona potencial për energji të ripërtritshme të futet. Kemi lejen prej ministrisë. Tash të gjitha zonat që kanë potencial dhe ka interes komuna për me i vendos për energji të ripërtrishme ka mundësi, procedurat tjera pastaj shkojnë me ministri, ata nuk jan me neve. Te dëgjimi publik, ne e bajmë shqyrtimin publik gjatë hartimit të hartave zonale dhe komuniteti mundet me ardh aty dhe me pa se çfarë është parapa me harta zonale për vendbanimin e tyre. Deri tani nuk kemi pas ndonjë kundërshtim asnjëherë, nuk besoj që ka ndonjë ndikim negativ të komunitetit përreth aty dhe gjithmonë merret një distancë prej shpijave të fundit. Kemi parapa edhe në Ramjan, Goshicë, Sllatinë që ka një distancë prej shtëpive.

**z.Basri Sylejmani:** Ne dje kemi pas një takim me USAID. A përfshihet edhe kjo në atë hartën që e projektoj këta që kanë dje? D.m.th kjo përfshihet dhe nuk ka pengesë kjo.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Ky është investim afatgjatë, nëse shkurtohen vitet nuk ja vlenë dhe investimi.

**z.Jakup Demiri:** Hartat zonale hala nuk janë kry, nuk mundemi ne me thanë që janë bë se e murrë një përgjigje, Basria. Ne për harta zonale nuk dimë se nuk kemi pa dokument, ne jemi institucion, duhet dokument dhe jo fjalë.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Unë thashë ka mundësi zonat të cilat kanë potencial për energji të ripertrishme në aspektin ligjor me i futë në harta zonale. Ne nuk i kemi hartat, kemi fillu në hartimin e tyre dhe në vazhdimsi, pastaj sa bëhet ajo nuk e di, por ka mundësi me u akomodu kjo pjesë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Drejtoresha e bënë inicimin dhe drejtoria nuk varet më për leje, janë instanca të nivelit qendror të cilët e dinë edhe që e kemi të aprovuar planin zhvillimor komunal, edhe qe jemi në proces të hartave zonale, prandaj leja jepet nga ana e tyre edhe që ka me e vlerësu edhe çështjen mjedisore, por konsideroj që institucioneve lokale është që ne të interesuarit me ja dhanë hapësirën për kërkim të lejes edhe për zhvillim të veprimtarisë së tyre.

**z.Ilir Zuka:** Unë pajtohem me drejtorin që e ceku që investimet që janë tu bë të mëdhaja që po kërkohen me u ul vitet. Unë kisha kërku me vazhdu me ate që e kemi pas me kërku kushtëzimi që me vjet me fillu investimet e jo me marrë tokën e mos me invesitu për kohë të gjatë, e për me ja ul vitet mënoj që janë mirë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Drejtor a ka mundësi qe qet propozim me naj kthy të kundërligjshëm Ministria, se kur ta banë shqyrtimin ministria i keshyrë hartat zonale, nuk jan të përfunduara, edhe pa i pas hartat zonale naj kthen, d.m.th aspekti ligjor a mundet me naj kushtu qekjo qe me naj kthy pa përfundu hartat zonale.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Aspektin ligjor mundet me ditë Zyra Ligjore, po vendimi i ministrisë mundet me përfshi që zonat me potencial siç është zona në Devajë me potencial për energji të ripërtrishme mundet të futet, po ne jemi në proces të hartimi të hartave zonale, kështu që këtë e dinë juristat më mirë.

**z.Ali Bajrami:** Përpos Devajës u përmenden edhe Gushica. Drejtori në Gushicë nuk u përmend në PZHK që e kemi votu. Kam qenë pjesë e punimeve që i kemi pas tri ditore në Gushicë. Çka jeni tu parapa me dhanë pronë komunale, me dhanë a tokë të sektorit privat, një gjë që nuk është në PZHK, që nuk e kemi votu në kuvend, se na e kemi votu PZHK, nuk ka qenë me dhanë vizën për me i hartu hartat zonale, e këto harta dje janë diskutu as aty nuk i kam pa që janë të parapamë për qet destinacion, prandaj kush është ai organ që mundet me e ndryshu një vendim të kuvendit që është votu para një viti apo dy. Plani Zhvillimor Komunal edhe hartat zonale që janë në procedurë, mu po me doket si vendi që nuk po muj me e justifiku qysh janë përfshi dhe me i dhanë kur si kuvend nuk i kemi votu.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Pjesa që është parapa për panele solare në Gushicë, ka qenë pjesë e drafteve të një pas njëshme që ka ardh në kuvend, ka qen e publikuar edhe në web të komunës. Është obligim ligjor publikimi aty dhe kemi mbajt shqyrtimet publike nëpër bashkësi lokale, ku kanë qenë të ftuar të gjitha bashkësitë lokale më rastin e miratimit ka qenë këtu. Unë nuk po di qysh me thanë nuk ka qenë kur është. Edhe matrialin që e keni marr ju këshilltarët komunal për atë seancë kur ka qenë pikë e rendit të ditës e keni pas aty edhe keni muj me marr informacione se nuk po e kuptoj, herë po thuani nuk është e herë është, e nëse nuk është pse po e bani problem, nëse është hajdni në drejtori edhe merrni informacione. Po nuk mudet Plani Zhvillimor Komunal mas tij me bë vendim ose me rividu qysh po thu nuk lejohen këto. Unë muj me u ofru fakte që ajo ka qenë në të gjitha draftet e publikuara e keni marr edhe ju këshilltarët, sepse sekretaria e ka dërgu dhe ka qenë dëgjimi publik ne bashkësi lokale. I keni të gjitha publikimet, e në rast që nuk e keni lexu është tjetër sen.

**z.Ali Bajrami:** Unë nuk jam tu fol me hamendje, unë jam tu e thanë atë që e kemi pas në kuvend qetu që e kemi votu çka e keni majt ju, çka keni propozu. Unë nuk kam qenë pjesë e atyre debateve edhe nuk kam qenë i ftuar. Unë jam tu fol për procedurat, anën ligjore si këshilltar komunal edhe si kuvend komunal.

**z.Jakup Demiri:** Drejtor, hartat zonale kur naj keni pru qetu i keni qit vetëm me i votu, nuk kemi pas vakt me i votu e që kam pas reagu e kam votu kundër, se nuk kemi pas kohë as na me i analizu. Kërkush nuk e dinë se çka ka pas në ato harta zonale.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Jakup, me qenë pak me i qart, kush u zotu PZHK-ja apo hartat zonale, ti po thu hartat zonale.

**z.Jakup Demiri:** Për me e kalu qat material që me ja dhanë dikuj me i bë qetu janë ardh janë votu, janë kontrabandu se nuk mundem mi thanë ndryshe kësaj pune, se pasi që jemi kthy prej pauzës jan qitë edhe janë propozu me u votu.

**z.Bekim Azizi, kryesus i kuvendit:** E kemi një komplikim këtu. Në kuvend është miratu vetëm Plani Zhvillimore Komual. Hartat zonale, tash u nënshkru kontrata, dhe tash hapi i parë ka fillu me u përgatit Komuna e Vitisë. Nuk ka harta zonale, se me pas pas harta nuk e kishim diktu këtë pik hiq sot.

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Para 1 viti kam mbajt një fjalim në seancën e kuvendit komunal për këto gjëra të cilat po folen sot. Mendoj që nuk është e drejtë nëse mirret një vendim që është jetik për komunitetin që jeton me një vend, siç është fshati Goshicë e me shku me mbajt një mbledhje në Smirë e mu thirrë në bashkësi lokale, e që të mirat e pasojat i bart komuniteti ku jetojmë ne. Mos na sjellni probleme mes qytetarëve dhe institucioneve. Paraprakisht hajdeni uluni aty dhe flasim haptazi, jo si tha Jakupi dhe Aliu me i kontrabandu këto sene. Neser me pas problem pasojat i bartni ju. Kur është në pyetje shëndeti i qytetarëve dhe i komunitetit ku jetojmë, mbi të gjitha është qytetari, nuk është që nuk ja u kemi bë me dije dhe po ja u bajmë me dije prapë, aty janë 230 shtëpi, mbi 1200 banorë të cilët janë rritë, kanë jetu dhe jetojnë në një ajër që është lakmi për të gjitha fshatrat e Komunës së Vitisë. Duhet me ardh aty me folë dhe me majt kontakt drejtpërdrejt me qytetarin. Mos bani kësi gjëra pa i qartësu kjart qytetarët që jetojn në këto banime. E kam fjalën konkretisht për Goshicë. Unë e kam thanë më herët që, besoj që është e damshme për shëndetin e qytetareve nëse bahet diku 100 hektar. Me u shtru asfalt ndryshon ajri e mos të folim gjana e rreze. Ka vende dhe toka ku janë gurinë, kodrinë, ku nuk mundesh me ba prodhime bujqësore. Ja vlenë me bë kësi investime, mirëpo aty ku marrim bukën e gojës. Ju lutem flisni me qytetarin drejtpërdrejt.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Ne jemi tu folë për tokë të Devajës. Janë tu përgatit hartat zonale. Kompania e ka marrë tenderin. Ky është veç fillim i procesit, mos e devijoni debatin, të folim për pikën konkrete.

**z.Basri Sylejmani:** Ajo ndesh në të bahet ndesh jo, ama fjala kontraband na fynë shumë, se aty kontraband nuk ka, se ndoshta qeveria e tij bjen vendim për me u bë ai projekt, ne nuk mundemi me bë Vitia atë projekt.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Kuvendi punon me dokument, asgjë nuk mund me u bë pa dokument të planit zhvillimor. Këtë dokument e ka miratu ky kuvend, hartata zonale në fund kanë mu votu në këtë kuvend, deri atë ditë mund të diskutohet, mirëpo përpos kësaj dhe çdo vendimi i këtij kuvendi, ju e dini që e legjitimojnë ministritë e linjës. Për këtë arsye në këtë nuk mund ta kontrabandojmë, ne veç veprojmë me ligj në bazë të dokumenteve. Unë për atë po kërkoj kyqu për hartimin e hartave zonale për Goshicë.

**z.Ilir Zuka:** Unë e lexova këtë propozim vendim dhe nuk e pash emrin Goshicë askund. Nuk e di pse po e shndërrojmë foltoren në politikë. E dinë Sejda dhe Alia, për gjithçka që është në dëm të qytetarëve dhe ne nuk jemi, por ka pak po i devijomë, pak për interesa personale, pak në politikë, kështu që orientohemi në propozim vendim. Askush nuk e ceku Goshicën. Është një vend, na e shpjegoj drejtori, a i plotëson kushtet apo jo janë dy drejtora që i përkasin këtij propozim vendimi. Besoj që duhet me vazhdu me ju përmbajt këtij propozim vendimi. Ka qenë koha kur është dashtë me diskutu. Vjen prap koha për hartat zonale, kemi me dalë me mbrojtje. Në vitin e kaluar kemi mbajtë me drejtorin e urbanizmit në Pozheran takimin. Ne kemi cekë tokat me interes që janë të komunës. Çka mujn me bë, kush ka qenë i interesum ka mujt me bë takime. E ceka atë që është një investim i madhë. Nuk mendoj që duhet me ja jekë vjet, por mendoj që duhet me bë një komision me i nejt gati atë vendim që e leshojmë ne. D.m.th me u bë investimet jo me marrë me vite të tëra pa ivestu asgjë.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë po e shofë që kanë kërku për 20 vite me ju dhanë një qytetari për vendosjen e paneleve solare. Panelet solare janë në çdo vend të zhvillum të botës. Janë të rëndësishme edhe në Komunën e Vitisë. Është mirë me pas panele solare, po unë pa u dakordu me askënd prej mendimit tem, panelet solare me ja dhanë dikujt për 20 vjet, ai i bënë 5 vite deri sa ti vendos për me i shti në funskion. Është shumë pak. Panelet solare janë shumë të rëndësishme në çdo vend të zhvillum të botës janë të vendosura panelet solare në kësi hapësira siç është kjo e Devajës. Në qoftë se biznesi është serioz, jo si disa biznese tjera që i kemi dhanë, disa ende s'ja kanë fillu punës. Është serioz, unë jam pro, se është një zhvillim i jashtëzakonshëm. Nuk duhet me i diskutu me një sipërfaqe siç është Devaja mos me ja dhanë dikujt panele solare. Po në qoftë se është biznes serioz që i kryn punët në bazë të afateve ligjore. Ti sot i përcakton. Unë jam pro ksaj. Sa të ketë biznese, sa të ketë investime, se nuk është i vogël investmi me vendos panela solare. Mua nuk më doket me diskutu për një çështje ku çdo vend i botës jeton dhe vepron prej paneleve solare.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Dëgjimi publik. Ne me ligj i kemi 30 ditë shqyrtimet publike. Nuk mundemi 40 katune me shku me organizu. Për atë i grupojmë në bashkësi lokale. Sejda si këshilltar komunal nga Goshica është dashtë si obligim me ardhë në Smirë, bashkë me këshillin e fshatit me ardh në Smirë me i kundërshtu këto ose çfardo qoftë. D.m.th njoftimet kanë qenë publike, mirëpo nëse këta nuk kanë ardh është përgjegjësi e tyre. Prandaj, faji është te ta. Dokumenti është miratu në kuvend komunal. Këtu nuk kam nij ndonjë kundërshtim këtu. Së paku mua nuk më kujtohet. Kështu që këto kauza tani që bahen për politka ditore.

**z.Ali Bajrami:** Më duket nuk kemi nevojë për promovim personal. Njihemi me do, jemi në mandatin e tretë me disa jemi dytin e të parin, prandaj ky fjalor nuk na nevojitet, edhe krejt kjo çka u disktuu dhe çka thamë e thamë me qëllimin më të mirë të mundshme për me bë zgjidhje që të është e pranueshme dhe për komunitetin dhe komunat që është ajo që i jep këto në shfrytëzim. Mua drejtor nuk më duket kjo e mirë dhe që po shprehesh, u kan njoftimi. Unë po të themë me sinqeritetin më të madh, nuk kam pas dijeni as nuk kam pas ftesë. Nuk po të themë me të thirrë special si këshilltar komunal, as si qytatar me thanë kemi fjetë. Nuk ka nevojë, se këto procedura, këto biseda krejt i kemi zhvillu në kuvend komunal. Krejt i kemi diskutu. Edhe një here po e diskutoj në PZHK që kemi votu. Nuk u përmend as Devaja, as Goshica, as ajo pjesa tjetër e tretë, që brenda qysh kanë rrjedh këto kanë rrjedh. Unë nuk kam njohuri, unë veç për këtë kërkova një spejgim dhe prapë po kërkoj. Në Goshicë a jeni tu parapa pronë komunale me dhanë a pronë private.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Unë nuk mendoj që do të jem as avokat i drejtorit, as i këshilltarëve. Në këtë rast avokat i ligjit po. Të nderuar këshilltar, konsideorj është përbërja e shtatë e kuvendit komunal, kjo që pas luftës dhe tani ne duhet me u gjetë me profesionalizëm, dhe kur po e themë këtë kam qëndru krah për krah me drejtorin gjatë hartimit të PZHK-së, nuk ka hapë ligjor që ka ekzistu që nuk e ka ndjek. Dhe në këtë kontest që po i thuni pse nuk ke ardhë në Goshicë. Ai ka pas lokalitete me anë të profesinalistave që i kanë caktu në Skifteraj, Pozheran, Smirë, në lokalitete më të mëdha që të gravidojnë dhe lokalitetet më të vogla dhe të bisedojnë. Përveç kësaj, 1 muaj këtu kush ka dashtë prej anës profesinale kanë qëndru dhe janë grumbullu të gjitha kërkesat, ankesat që kanë qenë të qytetarëve në adrezë të planit zvhillimor komunal. Prandaj, në fund ka ardh te ju dhe e keni aprovu. D.m.th që është e pashmangshme. Këto janë hapa ligjor që duhet me i ndjek. Tani jemi hi me një tjetër në hartimin e hartaave zonale. Dje ka qenë diskutimi publik. Do të jenë në vazhdimsi të jeni aktiv për të gjitha ato të cilët mendoni, por nuk ka nevojë me dalë mbrojtës i Remnikut tonë, se del ligji. Apo i Goshicës, apo tjetri, se këto çështje duhet zhvillohen në aspekt procedural ligjor, dhe kontributi i krejt asaj është të kontribojm kur është koha. Pas kohës sikur i qëndron ajo parapolitika po i prinë politikes. Jo, duhet në kohë të nxihet hapi, të jepet mendimi ytë i bazuar dhe të mirret parasysh. Nuk ka dokument që prodhohet që mendojmë që duhet me demantu një qytetar, por në kohë duhet me i parapa. Unë besoj në profesionalizimin e njerëzve të cilët e japin atë që është leja mjedisore a sjellë dëme a e shkatrron natyrën. Unë besoj që nuk punojnë ata në bazë të qefeve të Hasanit apo Sejdes, punojnë në bazë të literaturës, ligjeve të cilat i kemi të aprovume, të cilat janë në fuqi, që duhet zbatohen. Kurse tjetër, kjo nuk ishte temë, tema ishte te parcela në Devajë dhe ne po bisedojmë për Devajë. Ju jeni ata të cilët ja jepni të interesuarit hapat e parë për me i zhvillu ai procedurat, për me u pajisë ai me leje, dhe prapë ai ka me u rikthy këtu. Erdh Taulanti me vonesë. Unë do të ja uroj kandidaturën dhe me shpresë. Kam qef të gjithë kandidatët që propozohen nga vitia, kam dëshirë me i pas në parlament.

**z.Sejdi Emini:** Me folë fole rrafsh. Ti je kanë ndërmjetësues edhe i disa odave. Tash po mi anashkalon 1200 1300 banorë. Nuk po e shef të aryshme me shku me folë e me u shtru në vendin ku i kanë rritë edhe bagëtit qaty babë e babagjysh, dhe po thu që bashkësitë lokale. Unë shumë mirë i di këto sene, por prapë po kërkoj, jo veç qëkjo në Goshicë, por kudo qoftë me një fshatë që ka me rëndësi jetike për ta është me rregull me shku. Me u ulë në Goshicë jo në Smirë, se banorët binduni që nuk e dinë 99% që Aliu po të argumenton atë. Këtë po e kërkojmë, se di qysh po doni mi dhanë kahje.

**z.Basri Sylejmani:** Më fyese ke fjala kontrabantë se fjala fjetje. Në qoftë se kemi çështje të Goshies dhe unë e mbroj, por nuk e kemi çështjen e Goshicës, kemi çështjen e Vishoces a me dhanë a mos me dhanë. Faktikisht unë mos me shku në Sodovinë dhe Sllatinë me mbajt këtë mbledhje në këtë debat, atëhere unë kam fjet jo drejtori.

**z.Jakup Demiri:** Kjo puna e këtij debati u hapë prej drejtorit se u përmend emri Goshicë. Te fjala kontrabad. Basri, na kur kemi disktu në KPF dhe aty nuk jemi pajtu që ai material aq shumë voluminoz diku 70/80 faqe me na ardh në kuvend dhe vetëm ditën e kuvendit kemi diskutu dhe në KPF se është material voluminoz, por edhe në kuvend kur na kanë pru na ka ardh në pjesën a dytë të mbledhjes dhe aty për aty e kemi miratu. Unë nuk kam çka me i thanë atij dokumenti tjetër sen Basri. Si shprehje ndoshta tingëllon, por kemi votu dokument pa e lexu, dhe dokument me rëndësi. Ma e keqe është ajo që ka ndodhë se ajo që po themë unë.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Unë kam propozim që kjo të bëhet 15 vite. Drejtoria ka propozu 20 vjet. Kur të vjen herën e dytë duhet ta përcakojmë për sa kohë duhet të bëhen investrimet, se pa e përcaktu kohën ne nuk mundemi me leju me i marrë pronat e me na mbet pronat peng nëpër njerëz. Te panelet solare janë pak 15 vite.

Është kërku 20 me mundësi vazhdimi, se nuk mundesh me ja jekë se mundesh me vazhdu. Propozimi prej drejtorisë na ka ardhë 20 vite. Jakupi prej VV-së propozoj 15 vite. Unë mendoj 15 është pak, mendoj që ky propozim 20 është i arsyeshëm, se kalon pjesën afatgjatë dhe është mundësia e vazhdimit. Ne kemi dhanë dhe 30-35 për lajthia përshembull, por mendoj që paneli solar është më i rëndësishëm, sepse paneli solar është kusht i BE-së, është investim edhe i Qeverisë së Kosovës që gjithmonë janë tu u shty investimet në enrgji të butë, energji që lidhen me erë dhe solar.

**z.Jakup Demiri:** Kjo puna e investimit të paneleve solare nuk është dikush këtu profesionalisht me na tregu se a mundet 15 vite apo nuk mundet, se ne jemi konsultu me dikan, nuk ka panele solare 20-vjeçare që vendosen. Panele solare ka 9 deri 13 vjet qëndrueshmëri maksimumi.

**z.Taulant Haxhiu:** Ne e perkrahim me 20 vite.

**z.Ali Bajrami:** Pasi është çështje veç me u qitë me fillu procedura për me dhanë, se prapë komisioni që do të caktohet do të vlerësoj ofertat, ne si grup e mbështesim, por fazën përfundimtare i shohim ofertat, propozimet, i shohim që janë serioze krejt edhe vendosim. Për këtë seancë jemi pro, për seancën e radhës është krejt temë tjetër.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** A jeni që të kaloj propozimi i drejtoreshës me 20 vite? Kush është për? Pra, me 21 vota pro, 0 kundër, 1 abstenim miratohet dhe kjo pikë.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

**znj.Majlinda OStergllava, drejtoreshë:** Ky është komisioni që i bashkangjitet po këtij propozimit që e patëm. 2 anëtar janë propozu nga kryetari dhe 3 tjerë mbeten këtu me u prpopozu.

**z.Basri Sylejmani:** Ne si grup parlamentar i LDK-së propozojm Ali Barjramin.

**z.Jakup Demiri:** Ne si grup parlamentar i VV-së propozojmë Remzi Salihun.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Nga shoqëria civile Shyqeri Halabaku, Ali Bajrami, Remzi Salihu. A jeni që kjo pikë të miratohet? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik**

**znj.Majlinda OStergllava, drejtoreshë:** Pasi që materialin e kemi, po e sqaroj në pika të shkurtra. Ka të bëjë me zonën me interes për parcelën e cila gjendet te shtëpia e kultures. Ka me u bë këmbim. Këtë seancë shpallet zonë me interes pas vlerësimit të Ministrisë së Financave, atëhere prapë rikthehet në kvuvend për këmbim. Aq metra sa kemi me dhanë aq kemi me marrë.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** E diskutum dhe në komitet, që pikat që vijnë të tilla për këmbim pa më ardh pjesa tjetër e planit, këto jan të kjarta që mund t'i diskutojmë. Kjo është kjo pjesa te shtëpia e kulturës që të bëhen 2 kahje.

**z.Ilir Zuka:** Para disa seancave kam kërku, se nuk e disha sa kemi hapësira për me bë dy kahje dhe për atë kam kërku që me u hjek shkallet e shtëpisë së kulturës, dhe ky është një ndër propozimet më të mira që ka mujtë me na ardhë, se kjo rrugë është që taman bënë lidhjen e qytetit dhe jam pro këtij.

**z.Jakup Demiri:** Pjesa mes 2 objekteve që është dhe me atë pjesën që e merrë prap nuk i plotëson kushtet inxhinierikisht. Ne jemi dalë, i kemi kqyrë dhe nuk i plotëson kushtet për rrugë 2 kahje.

**znj.Majlinda OStergllava, drejtoreshë:** I nderuar, janë ekspertat që konstatojnë a i plotëson kushtet për rrugë 2 kahje apo jo. Unë nuk jam eksperte e rrugëve unë, interes më të madhë për qytetar nuk ke, d.m.th qasje në qytet për me u bë rrugë 2 kahje, oblgiim i jemi është me shpall zonë me inetres, ministria e vlerëson dhe prapë ka me khty në kuvend për këmbim. Mundesh me diskutu.

**z.Jakup Demiri:** Majlindë, nuk është dashtë me reagu ashtu se nuk pate nevojë. Edhe ne jemi dalë e kemi kqyrë me ekspert, me inxhiniera, me ekspert të fushës dhe për atë me pas skicën këtu ne kishim diskutu. Puna nuk është e kryme prej drejtorisë për neve si asamblist për me diskutu në këtë rrafsh që po e disktojmë.

**znj.Majlinda OStergllava, drejtoreshë:** Për cilën skiç e ke fjalën? Fatlum a ua ke sjellë. Jakup 52 metra ke me i dhanë 52 ke me i marrë, plus është ministra që vlerëson, janë eksperta shumë më të mëdhaj që vlerësojnë.

**z.Jakup Demiri:** Pikërisht eskeprt prej ministrisë që ne kemi dalë në vendin e ngjarjes është shoki jonë prej Vitisë, por problemi a e dini ku është, se metra katror dallon nëse është në fund. Këtu mundesh edhe 500 metra katror, por pjesa tjetër nuk e ka, është situacioni i cili neve na tregon atë situacion. Ne nuk e kemi këtu që mundemi me folë profesionalisht. Unë e pash si reagim me tendencë negative, po të lamë a bënë a nuk bënë, se po kemi shumë probleme me këto ndërlidhje që po i bëjmë. Ajo veç është tu funksionu, ajo nuk ka kalu nëpërmjet kuvendit komunal, po veç e keni parë se sa vetura është dëmtu përtej lumit. Ato stubat me gurë 5-6 veç kanë ra në ujë, se i kanë goditë me vetura, se është ngusht.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Është pru për zgjerim të kësaj pjesës së rrugës. Tani kjo është punë e Drejtorisë së Inspeksionit që na vjen: a bëhet dy kajhje apo jo?

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Nuk e pata njëjtë me u kyç në këtë debat, por me irritoj pak drejtoresha se në çfarë mënyre reagoj me shumë nervozë. Këtu jemi tu bisedu për ndryshim të pronës, gjë që tash mund me marrë vendim a e kalojmë apo nuk e kalojmë. Mirëpo u diskutu edhe për rrugë 2 kahje, 1 kahje, pikërisht dhe u diskutu që ka profesionist dhe superprofesionist. Nëse janë këta atëherë lirsht mund të ju themë që kemi ne një superprofesionist këtu, ai i cili e udhëheq Komunën e Vitisë, ai është kryetari Sokol Haliti. Pse po e themë këtë, sepse ai merr vendime dhe bënë çdo gjë që ju teket atij, pa vendim të kuvendit për një kahje dhe 2 kahje. Mund ta cekim rrugën "Agim Ramadani". Ajo është rrugë 2 kahje që po qarkullojnë makinat dhe nuk ka vendim të kuvendit, prandaj këtu dashta me ditë që, super inxhiera kemi ne.

**z.Taulant Haxhiu:** Drejtoreshë, atë që po e marrim po e japim, por është mirë propozim vendimin kur është pikë e jotja, është mirë para se ne me disktu, është mirë ju me sqaru, e jo me thanë e keni matrialin. Është mirë me e sqaru, nuk po e dimë pse kanë mu dhanë këto 52 metra, arsyen me e ditë. Kur ta kish pikën e redit të ditës duhet me sqaru.

**z.Ilir Zuka:** E di sakt për eka është ky propozim vendim, për me bë me të letë kyqjen në qytet. Jam kanë një ndër të parët që kam kërku një zgjidhje më të mir për me lidh me qytetin.

**z.Ali Bajrami:** Pas sqarimit që u bë, mënyra e komponzimi me i dhan 51m e me i marr 51m është procedurë. Qëllimi është i mirë, se qysh ka qenë ajo rrugë ka qenë e ngushtë, prandaj iniciativa për zgjerimin e rrugës është e qëllueme dhe është e mirë. A do të bëhet një kahshe apo dy kahshe, jemi prapë në atë që vendimin. Kështu që ne si grup i LDK-së jemi pro këtij propozim vendimi.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Fillimisht ideja për me i hi kësaj proceduere ka qenë për shkak se ekzekutiva ka kërku nga ana e inspektorëve që edhe rruga "Agim Ramadani", edhe këtë rrugë me e bë rrugë dy kahje, edhe shkresa e cila ka ardh nga inspektori ka thanë që, kjo rrugë me gjendjen ekzistuese të cilën e ka nuk i plotëson kriteret ligjore me qenë rrugë dy kahshe, dhe neve na ka dashur me hi në negociata me pronarin, dhe pronari ka pranu variantin e këmbimit. Kemi mëndu edhe shpronësimin, po nuk e ka pranu këtë dhe e keni këtë propozimin. Tash këtu nuk kam dal në vendngjarje me e pa a i plotëson kriteret, po na kanë thanë që, nëse bëhet këmbimi i plotëson kriteteret, se ajo është rrugë e shkurt, po një zgjidhje e qarkullimit do të bënet dhe së bashku me rrugën "Agim Ramadani" dhe të tjerat që do të bëhen dy kahëshe do të ju vjen propozimi në kuvend dhe që e vendosni këtë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Çdo propozim që na vjen për zgjërim të rrugës jemi pro. Tani është fjala veç me u zgjeru rruga. A mbetë 1 kahje a 2 kahje, mirëpo si pjesë teknike kalon si pjesë e zgjerimit të kësaj pjese të rrugës.

**z.Jakup Demiri:** Unë nuk e pata me asgjë, unë kam dalë në vend të ngjarjes. Besoj që si asamblist e kam kry punën time që kam dal, e kam kqyrë. Dy objektet që janë, njëri i komunës, tjetri privat, hapësira mes objekteve e pamë sa patën hapësirë. Ne e mbështesim këtë.

